

 Ky publikim është financuar nga Qeveria Suedeze me mbështetje të Save the Children. Përgjegjësia për përmbajtjen qëndron tek zhvilluesi i saj. Qeveria Suedeze apo Save the Children jo domosdoshmërisht i ndan pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.

Tabela e Përmbajtjes

Lista e shkurtesave.....	3
1. Hyrje.....	4
2. Legjislacioni i qëndrueshëm mjedisor, perspektiva e aftësisë së kufizuar dhe të drejtat e fëmijëve.....	5
3. Legjislacioni mjedisor në Republikën e Kosovës dhe ndërlidhshmëria me aftësinë e kufizuar dhe të drejtat e fëmijëve.....	8
3.1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.....	9
3.3. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.....	12
3.4. Obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në raport me legjislacionin dhe politikat mjedisore.....	14
4. Përfundim dhe Rekomandime.....	16

Lista e shkurtesave

BE – Bashkimi Evropian

KE – Komisioni Evropian

MMPHI – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës

MSA – Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

OJQ – Organizata Joqeveritare

OZHQ – Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

VMN – Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor

VSM – Vlerësimi Strategjik Mjedisor

1. Hyrje

Në kërkimin për një të ardhme të qëndrueshme, rëndësia e legjislacionit mjedisor shkon përtej ruajtjes së ekosistemeve dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike – ai shtrihet në garantimin e gjithpërfshirjes dhe mbrojtjen e të drejtave të kategorive të ndryshme të shoqërisë së një vendi. Një kryqëzim i tillë kritik qëndron në njohjen e perspektivave të personave me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve brenda kuadrit të politikës mjedisore.

Në qendër të zhvillimit të qëndrueshëm është parimi se askush nuk duhet të lihet pas. Njerëzit me aftësi të kufizuara përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë globale dhe nevojat dhe perspektivat e tyre unike shpesh anashkalohen në diskursin konvencional mjedisor. Legjislacioni mjedisor i qasshëm dhe gjithpërfshirës siguron që individët me aftësi të kufizuara jo vetëm të mbrohen nga efektet negative të degradimit të mjedisit, por janë gjithashtu pjesëmarrës aktivë dhe përfitues të nismave të qëndrueshmërisë.¹

Në anën tjetër, fëmijët, si trashëgimtarë të planetit, janë veçanërisht të cenueshëm ndaj pasojave të neglizhencës mjedisore. Legjislacioni që nuk merr parasysh të drejtat dhe dobësitë specifike të fëmijëve mund të rrezikojë pa dashje mirëqenien e tyre dhe perspektivat e ardhshme. Një qasje gjithpërfshirëse ndaj legjislacionit të qëndrueshëm mjedisor duhet të marrë parasysh ndikimet e menjëhershme dhe afatgjata në të drejtat e fëmijëve, duke përfshirë të drejtën e tyre për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, arsim dhe mirëqenie të përgjithshme.

Ndërlidhja e qëndrueshmërisë mjedisore, të drejtave të aftësisë së kufizuar dhe të drejtave të fëmijëve bëhet e dukshme kur merren parasysh çështje të tilla si planifikimi urban gjithpërfshirës, hapësirat e gjelbra të qasshme dhe praktikat arsimore miqësore me mjedisin. Legjislacioni i qëndrueshëm që përfshin këto konsiderata jo vetëm që mbron mjedisin, por gjithashtu nxit një shoqëri gjithpërfshirëse ku të gjithë, pavarësisht nga aftësia apo mosha, janë të barabartë.

Ky dokument paraqet një analizë të shkurtër, por gjithpërfshirëse për qëllime avokuese. Objektive kryesore e këtij punimi është të analizojë një perspektivë ligjore për përfshirjen e aftësisë së kufizuar në iniciativat e qëndrueshmërisë mjedisore që synojnë fëmijët. Përmes këtij dokumenti do të analizohet korniza ligjore relevante në Republikën e Kosovës, përkatësisht dispozitat kushtetuese, legjislacioni, politikat dhe rregulloret që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë mjedisore dhe ndërthurjen e tyre me konsideratat e aftësisë së kufizuar, duke përfshirë edhe perspektivën e të drejtave të fëmijëve. Kjo analizë do të shërbejë si një burim themelor për të udhëhequr zhvillimin e programit të HANDIKOS-it, përpjekjet e avokimit, si dhe materialet edukative dhe avokuese.

¹ Jackson, M. A. (2018). Models of disability and human rights: Informing the improvement of built environment accessibility for people with disability at neighborhood scale? *Laws*, 7(1), 10.

Fillimisht, punimi do të ofroj një pasqyrë të shkurtër lidhur me ndërlidhjen mes legjislacionit të qëndrueshëm mjedisor dhe perspektivës së aftësisë së kufizuar dhe të drejtave të fëmijëve dhe fushat kryesore në të cilat mund të shfaqet kjo ndërlidhje. Më pas, do të analizohet legjislacioni pozitiv në Republikën e Kosovës, duke u identifikuar ligjet dhe dispozitat kryesore të cilat ndërlidhen me qëndrueshmërinë mjedisore, aftësinë e kufizuar dhe të drejtat e fëmijëve. Ky dokument do të identifikojë institucionet dhe mekanizmat përgjegjës për zbatimin e ligjeve dhe politikave, duke ofruar një mundësi për të njohur akterët kryesorë dhe përgjegjësitë e tyre në zbatimin e politikave rreth legjislacionit mjedisor dhe ndërlidhes me aftësinë e kufizuar dhe të drejtat e fëmijëve. Tutje, ky dokument do të identifikojë fusha dhe mundësi specifike për t'u angazhuar në kampanja avokuese, si rekomandime konkrete lidhur me akterët, fushat dhe qasjen në aktivitete avokuese që ndërlidhen me qëndrueshmërinë mjedisore, aftësinë e kufizuar dhe të drejtat e fëmijëve.

2. Legjislacioni i qëndrueshëm mjedisor, perspektiva e aftësisë së kufizuar dhe të drejtat e fëmijëve

Ndërthurja e qëndrueshmërisë mjedisore, perspektivës së aftësisë së kufizuar dhe të drejtave të fëmijëve paraqet një domosdoshmëri të kohës, në një periudhë të zhvillimit të hovshëm inustrial dhe implikimeve të konsiderueshme mjedisore. Këtu duhet marrë parasysh disa elemente kryesore kur kombinohen këto tre këndvështrime, të cilat do të garantonin përfshirjen e perspektivës së aftësisë së kufizuar dhe të drejtave të fëmijëve në politikat lidhur me qëndrueshmërinë mjedisore. Këto elemente ose fusha, të cilat do të sqarohen në vijim, janë të domosdoshme për t'u konsideruar nga ligjvënësit dhe dizajnesit e politikave të qëndrueshme mjedisore, për të siguruar gjithëpërfshirje dhe garantim të perspektivës së aftësisë së kufizuar dhe të drejtave të fëmijëve. Këto elemente/fusha janë:

- ***Mjedise të qasshme dhe gjithëpërfshirëse***, ku përfshihet qasja fizike dhe projektimi gjithëpërfshirës. Qasja fizike ka të bëjë me hartimin dhe zbatimin e praktikave të qëndrueshme që i japin përparësi qasjes fizike për individët me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët. Kjo përfshin infrastrukturën e qasshme, transportin dhe hapësirat publike. Kurse, projektimi gjithëpërfshirës nënkupton zbatimin e parimeve të projektimit gjithëpërfshirës për të siguruar që iniciativat mjedisore marrin në konsideratë nevojat e ndryshme të individëve me aftësi të kufizuara, duke lehtësuar pjesëmarrjen e tyre dhe gëzimin e hapësirave të qëndrueshme.
- ***Edukimi dhe ndërgjegjësimi***, që përfshinë edukimin mjedisor gjithëpërfshirës dhe organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit publik. Edukimi mjedisor gjithëpërfshirës nënkupton integrimin e programeve të edukimit mjedisor që janë gjithëpërfshirëse dhe të qasshme për të gjithë, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara. Kjo mund të rrisë ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit e praktikave të qëndrueshme tek fëmijët me aftësi të

ndryshme. Kurse, fushatat e ndërgjegjësimit publik duhet të synojnë promovimin dhe qëndrueshmërinë mjedisore dhe të drejtat e aftësisë së kufizuar, duke nxitur një kulturë përfshirjeje dhe mirëkuptimi.

- **Teknologjia dhe Inovacioni**, e cila përfshinë teknologjinë ndihmëse dhe inovacionin gjithpërfshirës. Teknologjia ndihmëse nënkupton inkurajimin për zhvillimin dhe integrimin e teknologjisë për të lehtësuar pjesëmarrjen e individëve me aftësi të kufizuara në nismat mjedisore. Kjo mund të përfshijë teknologji që rrisin qasjen në transportin e qëndrueshëm, menaxhimin e mbetjeve ose përdorimin e energjisë. Për më tepër, përmes inovacionit gjithpërfshirës, mund të realizohet nxitja e inovacionit në praktikën e qëndrueshme që marrin në konsideratë nevojat dhe kontributet e personave me aftësi të kufizuara, duke siguruar që teknologjitë dhe zgjidhjet e reja janë përfshirëse nga dizajni.
- **Të drejtat dhe mirëqenia e fëmijëve**, që nënkupton garantimin e mjedisëve të sigurt dhe garantimin e pjesëmarrjes së fëmijëve në procese vendimmarrëse. Një qasje e tillë siguron që praktikën e qëndrueshme i japin përparësi krijimit të mjedisëve të sigurt dhe mbështetëse për fëmijët, duke marrë parasysh nevojat e tyre fizike dhe zhvillimore. Po ashtu, me këtë qasje, mbrohen të drejtat e fëmijëve për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse që lidhen me qëndrueshmërinë mjedisore.
- **Përgatitja dhe reagimi ndaj fatkeqësive**, gjegjësisht planifikimi gjithpërfshirës i urgjencës. Garantimi i kësaj perspektive sigurohet përmes hartimit dhe zbatimit të planeve emergjente që përfshijnë individët me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët. Kjo përfshin marrjen në konsideratë të rrugëve të evakuimit, strategjive të komunikimit dhe shërbimeve mbështetëse gjatë fatkeqësive mjedisore ose krizave.
- **Integrimi i politikave ndërsektoriale**, që nënkupton integrimin e perspektivës së aftësisë së kufizuar dhe perspektivat e të drejtave të fëmijëve në politikën mjedisore dhe anasjelltas. Ligjvënësit duhet të sigurohen që politikën adresojnë nevojat dhe të drejtat specifike të individëve me aftësi të kufizuara dhe të fëmijëve në kontekstin e qëndrueshmërisë mjedisore.
- **Projektet gjithpërfshirëse të komunitetit**, përmes angazhimit në projekte të qëndrueshme që janë gjithpërfshirëse dhe të qasshme për individët me aftësi të kufizuara. Kjo nxit një ndjenjë komuniteti dhe siguron që të gjithë mund të përfitojnë dhe të kontribuojnë në iniciativat mjedisore.

Marrja në konsideratë e legjislacionit të qëndrueshëm mjedisor nga këndvështrimi i personave me aftësi të kufizuara dhe të drejtat e fëmijëve është parësor për disa arsye bindëse, që ndërlidhen edhe me garantimin e përfshirjes dhe barazisë, shëndetit dhe mirëqenies, mundësive të barabarta për arsimim, ndikimin afatgjatë dhe qëndrueshmërisë, dhe në përgjithësi garantimin e të drejtave fundamentale.²

² ONCIOIU, I., & NEACSU, N. (2023). ENVIRONMENTAL LEGISLATION. The Green Deal “For A Greener Future”, 52.

Përfshirja siguron që individët me aftësi të kufizuara të mos marginalizohen ose të ndikohen në mënyrë disproporcionale nga politikat mjedisore. Duke përfshirë veçoritë e qasjes në planifikimin urban, transportin dhe hapësirat publike, legjislacioni i qëndrueshëm nxit një mjedis gjithëpërfshirës për të gjithë. Fëmijët, në anën tjetër, si anëtarë të cenueshëm të shoqërisë, kërkojnë një konsideratë të veçantë. Legjislacioni i qëndrueshëm që respekton të drejtat e fëmijëve promovon akses të barabartë në ajër të pastër, ujë dhe mjedise të sigurta, duke nxitur ndjenjën e barazisë që në moshë të re.

Faktorët mjedisorë mund të ndikojnë ndjeshëm në shëndetin dhe mirëqenien e individëve me aftësi të kufizuara. Legjislacioni i qëndrueshëm që merr parasysh nevojat e tyre unike shëndetësore siguron që ata të mund të lulëzojnë në një mjedis mbështetës dhe të shëndetshëm. Fëmijët janë më të ndjeshëm ndaj ndotësve mjedisorë dhe ekspozimi mund të ketë pasoja afatgjata për shëndetin. Legjislacioni që mbron të drejtat e fëmijëve kontribuon në krijimin e mjediseve që mbështesin mirëqenien e tyre fizike dhe mendore.³

Legjislacioni i qëndrueshëm mund të ndikojë në objektet arsimore, duke siguruar që ato të jenë të qasshme dhe të përshtatshme për individët me aftësi të kufizuara. Kjo përfshirje promovon akses të barabartë në arsim dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Mjediset e qëndrueshme në shkolla jo vetëm që kontribuojnë në një atmosferë më të shëndetshme mësimore, por gjithashtu rrënjos tek fëmijët një ndjenjë përgjegjësie dhe ndërgjegjësimi për rolin e tyre në ruajtjen e mjedisit për brezat e ardhshëm.

Marrja parasysh e nevojave të personave me aftësi të kufizuara në legjislacionin e qëndrueshëm rrit edhe pjesëmarrjen e tyre në politikbërje. Planifikimi për infrastrukturë dhe shërbime të aksesueshme siguron që të gjithë mund të përgjigjen në mënyrë efektive dhe të rikuperohen nga sfidat dhe fatkeqësitë mjedisore. Legjislacioni i qëndrueshëm që trajton ndikimin afatgjatë të vendimeve mjedisore mbron të drejtat e fëmijëve për t'u rritur në një botë jo vetëm të qëndrueshme mjedisore, por edhe sociale dhe ekonomike.

Drejtësia mjedisore është e ndërthurur me drejtësinë sociale. Duke siguruar që praktikat e qëndrueshme janë gjithëpërfshirëse, legjislacioni pranon ndërlidhjen e të drejtave të ndryshme të njeriut dhe promovon një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë.

Në përmbledhje, integrimi i perspektivave të personave me aftësi të kufizuara dhe të drejtave të fëmijëve në legjislacionin e qëndrueshëm mjedisor është thelbësor për ndërtimin e një shoqërie që nuk është vetëm përgjegjëse ekologjike, por edhe shoqërisht e drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Ai njeh nevojat e ndryshme të të gjithë anëtarëve të komunitetit dhe punon drejt një të ardhmeje ku qëndrueshmëria mjedisore është sinonim i mirëqenies dhe barazisë universale.

Duke integruar konsideratat e aftësisë së kufizuar dhe perspektivat e të drejtave të fëmijëve në përpjekjet për qëndrueshmërinë mjedisore, shoqëritë mund të punojnë drejt krijimit të mjediseve

³ UNICEF: Breathless beginnings: the alarming impact of air pollution on children in Europe and Central Asia, fq.2. I qasshëm në: <https://www.unicef.org/eca/media/30816/file/Breathless%20beginnings.pdf> (qasur me 22.12.2023)

më gjithëpërfshirëse, të barabarta dhe të qëndrueshme për të gjithë, pavarësisht nga aftësitë apo mosha e tyre. Kjo qasje promovon një vizion të qëndrueshmërisë që është vërtet gjithëpërfshirës dhe nuk lë askënd pas.

3. Legjislacioni mjedisor në Republikën e Kosovës dhe ndërlidhshmëria me aftësinë e kufizuar dhe të drejtat e fëmijëve

Republika e Kosovës ka një numër të konsiderueshëm të ligjeve, strategjive, udhëzimeve e rregulloreve të cilat rregullojnë aspektin mjedisor, dhe me të cilin mund të ndërlidhet edhe perspektiva e aftësisë së kufizuar dhe të drejtat e fëmijëve. Ky legjislacion mund të kategorizohet në dy grupe: grupi i parë përmbanë ligje të cilat janë specifikisht të ndërlidhura me mjedisin dhe politika mjedisore, kurse në grupin e dytë janë ligje tjera që jo domosdoshmërisht ndërlidhen me mjedisin, por të cilat kanë ndikim të madh në çështje mjedisore. Në këtë drejtim, disa nga ligjet kryesore janë:

- Ligji Nr.03/L- për Mbrojtjen e Mjedisit
- Ligji Nr.08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- Ligji Nr.08/L-145 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes;
- Ligji Nr.08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-197 për kimikate;
- Ligji Nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-060 për mbeturina;
- Ligji Nr.08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
- Ligji Nr.08/L-065 për produktet biocide;
- Ligji Nr.08/L-027 për mbeturinat nga industrinë nxjerrëse të mineraleve;
- Ligji Nr.08/L-010 për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor.

Dokumentet strategjike për të cilat Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës është përgjegjëse për zbatim janë:

- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë 2021-2030;⁴
- Draft Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve;⁵
- Strategjia për Ndryshime Klimatike 2019-2028 dhe Plani i Veprimit për vitet 2019-2021⁶.

⁴ Strategjia dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë 2021-2030. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?2022ActID=42930> (qasur me 06.12.2023)

⁵ Draft Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve. I qasshëm në: <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/plani-kombetar-per-zvogelimin-e-emisioneve-03-09-2019/> (qasur me 05.12.2023)

⁶ Gazeta Zyrtare: Strategjia për Ndryshime Klimatike. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=29356> (qasur me 05.12.2023)

Në anën tjetër, ekzistojnë edhe zotime programore e ndërkombëtare, të cilat Republika e Kosovës i ka marrë përsipër për zbatim. Specifikisht, disa nga këto zotime derivojnë nga:

- Agjenda e Gjelbërt e Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor;
- Gjetjet e Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Për qëllim të këtij dokumenti, do të analizohen detajisht Ligji Nr.03/L-025 për Mjedisin dhe Ligji Nr.08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, duke u trajtuar të gjitha dispozitat që ndërlidhen me aftësinë e kufizuar dhe të drejtat e fëmijëve. Meqë qëllimi i kësaj analizë është identifikimi i hapësirave ligjore të cilat do të krijojnë bazë për avokim për çështje që ndërlidhen me qëndrueshmërinë mjedisore, vëmendje e posaçme do t'u kushtohet vetëm këtyre dispozitave, pa u lëshuar në interpretime më të gjera të ligjeve.

3.1.Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik dhe politik i vendit, në mënyrë afirmative garanton jo vetëm mbrojtjen e ambientit, por edhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara si dhe të drejtat e fëmijëve. Fillimisht, kushtetuta garanton parimin e barazisë para ligjit. Specifikisht, neni 24, paragrafi 2 i Kushtetutës përcakton se “*askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal*”. Kjo dispozitë është detajuar më tej në shumë ligje tjera specifike, përfshirë këtu edhe Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Përgjegjësinë për mjedisin jetësor Kushtetuta njëkohësisht e definojnë edhe si obligim të të gjithëve për ruajtjen dhe përmirësimin e natyrës dhe të biodiversitetit, të mjedisit jetësor dhe të trashëgimisë kombëtare. Garancia kushtetuese është parimore, ndërsa e plotëson edhe një dispozitë, e cila i rregullon detyrimet dhe obligimet lidhur me ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor.⁷

Një dispozitë kushtetuese tejet e rëndësishme në lidhje me qëndrueshmërinë mjedisore, aftësinë e kufizuar dhe të drejtat e fëmijëve është neni 52 i Kushtetutës, e cila parasheh përgjegjësinë për mjedisin jetësor. Paragrafi 1 i nenit 52 të Kushtetutës përcakton se “*natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin*”. Megjithatë, dispozita kryesore që krijon obligim kushtetues për të gjitha institucionet publike për të garantuar gjithpërfshirje në dizajnim të politikave mjedisore është paragrafi 2 i nenit 52 të Kushtetutës, i cili

⁷ Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, fq.198. I qasshëm në: http://jus.igjk.rks-gov.net/506/1/Komentari_Kushtetuta_11_Shqip.pdf (qasur me 04.12.2023)

potencon se “*institucionet e pushtetit publik angazhohen për t’i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton*”. Kjo nënkupton që pavarësisht në cilin nivel mirren vendimet, të gjithë qytetarët e vendit kanë të drejtë që të ndikojnë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku jetojnë, duke u dhënë kështu të drejtë në vendimmarrje lidhur me politikën mjedisore. Edhe paragrafi 3 i nenit 52 konstaton se “*ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve*”, e cila obligon institucionet publike që për secilin vendim që mirret, të konsiderojnë perspektivën e ndikimit në mjedisin jetësor.

3.2.Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit

Duke pasur parasysh se Kushtetuta vetëm parimisht e rregullon përgjegjësinë për mjedisin jetësor dhe nuk e trajton më detajisht këtë çështje, konkretizimin e dispozitave kushtetuese mund ta gjejmë në Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit.⁸ Me këtë ligj harmonizohen zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian. Ndër synimet kryesore të këtij ligji, ndër të tjera, është edhe *përmirësimi i kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut*.⁹

Neni 6 i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit përcakton parimet themelore të kësaj fushe, të cilat janë të ndërlidhura ngushtë me perspektivën e aftësisë së kufizuar dhe të drejtat e fëmijëve. Përmes paragrafit 1 të nenit 6, ligji i referohet parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, duke e cilësuar si “*zhvillim që plotëson nevojat e së tashmes dhe të së ardhmes pa prekur mundësitë dhe kapacitetet që edhe brezat e ardhshëm t’i plotësojnë nevojat e tyre*”. Ky nen parasheh edhe parime tjera, siç janë parimi i integritetit të mbrojtjes së mjedisit, i cili obligon autoritetet publike për bashkëpunim dhe koordinim të punëve për zhvillimin dhe adoptimin e çdo mase, standardi apo aktiviteti që ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit. Një nga parimet kryesore që përcaktohet me nenin 6, paragrafi 12, është parimi i qasjes së publikut në vendimmarrje dhe në informata. Sipas kësaj dispozite, “*secili person juridik ose fizik ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe të marrë pjesë në vendimmarrje*”.¹⁰

Neni 20 i ligjit përcakton obligimin për miratimin e Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillim të Qëndrueshëm. Sipas ligjit, strategjia përfshinë objektivat dhe qëllimet për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës për një periudhë kohore dhjetë (10) vjeçare, me mundësi të rishikimit çdo dy (2) vjet. Paragrafi 4 i nenit 20 përcakton se “*strategjinë e harton Ministria në bashkëpunim me ministrinë tjera, institucionet shkencore të Kosovës, me publikun dhe palët e interesuara*”. Për

⁸ Ligji Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit. I qasshëm në Gazetën Zyrtare: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2631> (qasur me 04.12.2023)

⁹ Po aty, neni 2(2)

¹⁰ Po aty, neni 6(12)

më tepër, sipas nenin 20, paragrafi 5 të ligjit, “*Strategjia, para se të dërgohet në Qeveri, jepet në diskutim publik të paktën dyzetepesë ditë më qëllim që publiku të shpreh mendimet, sugjerimet dhe komentet, të cilat do të merren parasysh me rastin e hartimit të draftit final të Strategjisë*”. Kjo është një mundësi e shkëlqyeshme për të gjitha palët e interesuara që të marrin pjesë në hartimin e strategjisë, në mënyrë që të garantohet edhe perspektiva e aftësisë së kufizuar dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve përgjatë dizajnit të politikave mjedisore.

Sipas nenit 38 të ligjit, Ministria e njofton publikun për marrjen e masave të veçanta në raste të rrezikut të drejtpërdrejtë ose në raste të tejkalimit të nivelit të vlerave të përcaktuara të ndotjes së mjedisit. Në rastet kur ndotja është e përkufizuar vetëm në territorin e një komune të caktuar, Komuna në bashkëpunim me Ministrinë nxjerrë aktin për vendosjen e masave të posaçme.

Përmes ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, janë paraparë edhe masa afirmative, konkretisht shpërblime për arritje në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Sipas ligjit, këto shpërblime mund të ndahen për parandalimin e ndotjes së mjedisit; zgjidhjet më të mira në procesin e prodhimit në raport me mjedisin dhe shfrytëzimin e energjisë - teknologjia e pastër; projektet zhvillimore dhe hulumtuese në mbrojtjen e mjedisit; kontributin në zhvillimin e programeve të edukimit në mbrojtjen e mjedisit; kontributin e individëve për përparim në mbrojtjen e mjedisit ose për kontributin në bashkëpunimin ndërkombëtar në mbrojtjen e mjedisit; kontributin e shoqatave profesionale, OJQ-ve dhe të tjerëve në zhvillimin dhe përparimin e mbrojtjes së mjedisit.¹¹

Lidhur me monitorimin e mbrojtjes së mjedisit, neni 50, paragrafi 8 i ligjit parasheh se “çdo palë e interesuar ka të drejtë në çdo kohë të ketë qasje në regjistrat ose evidencat e Ministrisë që përmbajnë informata dhe të dhëna për gjendjen e mjedisit”. Kurse, lidhur me të drejtën për qasje në informata, neni 54, paragrafi 2 i ligjit përcakton që “publiku ka të drejtë për qasje në regjistra ose evidenca që përmbajnë informata dhe të dhëna në përputhje me ligjin”. Kjo e drejtë është në linjë edhe me të drejtat e qytetarëve për qasje në dokumente publike, që burojnë nga Ligji Nr.06/L-081 për Qasjen në Dokumente Publike. Neni 55, paragrafi 1 i ligjit po ashtu parasheh obligimin e institucioneve publike për dhënien e informatave të kërkuara nga ana e publikut, të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

Një nga nenet më të rëndësishme të këtij ligji është neni 57, i cili rregullon procesin e pjesëmarrjes të publikut në vendimmarrje. Sipas ligjit, organet vendimmarrëse sigurojnë pjesëmarrje dhe rol aktiv të publikut gjatë procesit të marrjes së vendimeve për:

- vlerësimin strategjik mjedisor;
- vlerësimin e ndikimit në mjedis;
- procedurën e lëshimit të lejes ujore dhe lejes integruese;
- nxjerrjen e ligjeve.

¹¹ Po aty, neni 44.

Kurse, paragrafi 2 i ligjit përcakton se "publiku informohet përmes mjeteve të informimit për procedurën e marrjes së vendimeve dhe merr pjesë në dhënien e mendimit, komenteve dhe sugjerimeve institucionit kompetent dhe me kohë informohet për vendimin e marrë".

Përmes nenit 71, ligji ka njohur edhe të drejtën për kompensim të dëmit, për personat të cilëve u shkaktohet dëm mjedisor. Secili që pëson dëm mjedisor ka të drejtë në kompensim. Kërkesa për kompensimin e dëmit mund ti parashtrohet drejtpërdrejt ndotësit ose siguruesit të tij, respektivisht garantuesit financiar të ndotësit tek i cili ka ndodh aksidenti, nëse një sigurues, respektivisht garantues financiar i tillë ekziston. Nëse më shumë ndotës janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar në mjedis, dhe nuk mund të përcaktohet saktësisht përgjegjësia e secilit ndotës, ata i bartin shpenzimet në mënyrë solidare, dhe veç e veç. Procedura për iniciimin e kompensimit të dëmit parashkruhet pas tre vjet prej momentit kur i dëmtuari ka kuptuar për dëmin e bërë dhe për dëmtuesin. Për çdo rast, kërkesa për kompensim parashkruhet pas tridhjetë vjet nga dita kur është shkaktuar dëmi.

Në fund, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, janë përcaktuar edhe institucionet përgjegjëse. Mbikëqyrjen administrative për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerrura nga ky ligj, e bënë **Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e këtij ligji si dhe akteve nënligjore të nxjerra prej tij, kushtet dhe metodën e punës së personave të mbikëqyrur si dhe masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me këtë ligj e bënë **Inspektorati mjedisor i Ministrisë**. Mbikëqyrjen inspektuese për Lejen Mjedisore Komunale e kryen **inspektori komunal i mjedisit**. Ministria mundet me autorizim të veçantë, të autorizoj inspektorin komunal të mjedisit për kryerjen e detyrave tjera.

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit paraqet edhe bazën për dy procese tjera të rëndësishme: Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VMN) dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM). Përderisa Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligj të veçantë për VMN, i cili do të trajtohet në vijim, projektligji për vlerësimin strategjik mjedisor aktualisht është në procedura të miratimit në Kuvendin e Kosovës. Në kohën e hartimit të kësaj analize, ky projektligj është miratuar në parim në Komisionin përkatës parlamentar për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim¹², dhe i njëjti pritet të miratohet në lexim të parë në seancë plenare.

3.3.Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

¹² Kuvendi i Kosovës, procesverbal nga takimi i Komisionit për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, i datës 18.07.2023. I qasshëm në: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Proc_2023_7_18_al_ExDtUxyUq4.pdf (qasur me 04.12.2023)

Ndonëse Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis¹³ është miratuar rishtazi, në vitin 2022, i njëjti nuk trajton detajisht qështjen e qëndrueshmërisë mjedisore nga perspektiva e aftësisë së kufizuar dhe të drejtave të fëmijëve. Ligji nr. 08/L-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit të dëmeve dhe efekteve negative në mjedis të projekteve publike apo private; të përcaktoj rregullat dhe procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të projekteve në mjedis, për të siguruar parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private; si dhe garantimin e një procesi gjithëpërfshirës dhe të hapur vendimmarrjeje përmes përcaktimit të rregullave dhe procedurave administrative, gjatë procesit të vendimmarrjes për pajisje me pëlqim mjedisor.

Neni 5 i ligjit rregullon kompetencat dhe përbërjen e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për VMN. Shqyrtimi i kërkesave për VNM bëhet nga Komisioni i VNM-së i përbërë nga pesë (5) anëtarë të cilët caktohen me vendim nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë. Ky Komision duhet të ketë përbërje multisektoriale brenda Ministrisë. Paragrafi 7 i nenit 5 të ligjit përcakton se në takimet e Komisionit *mund të marrin pjesë edhe përfaqësues nga shoqëria civile në cilësinë e vëzhguesit*. Kjo është një mundësi e mirë për organizatat e shoqërisë civile, përfshirë ato që mirren me të drejtat e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara, të marrin pjesë në takime dhe të njoftohen me zhvillimet në këtë drejtim.

Tutje, neni 7 i ligjit përcakton se VNM kërkohet për secilin projekt publik ose privat i cili mund të ketë efekte të theksuara në mjedis për arsye të natyrës së tij, madhësisë ose lokacionit. Aplikuesit nuk i lëshohet leja për ndërtim ose ndonjë leje tjetër për ndonjë projekt dhe ai nuk mund të filloj ekzekutimin e projektit përderisa të mos pajiset me pëlqim mjedisor. Llojet e projekteve dhe kategorizimi i tyre janë të listuara në dy shtojca të ligjit, të cilat janë pjesë përbërëse e tij.

Në vazhden e dispozitave të këtij Ligji, *transparenca e diskutimeve si dhe vendimmarrjes në të gjitha fazat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis* është e garantuar, siç parashihet me nenin 16. Publiku dhe palët e interesuara do të informohen në mënyrë elektronike dhe me njoftim publik në lidhje me proceset e VNM-së. Poashtu edhe autoritetet komunale të lokalitetit ku zhvillohen projektet në fjalë, janë të obliguara për organizimin dhe mbajtjen e debateve publike dhe transparencës së proceseve. Publikut dhe palëve të interesuara ju mundësohet po ashtu dërgimi i komenteve për kërkesën për përzgjedhje pas publikimit të saj nga ana e Ministrisë. Sipas ligjit, konsultimi publik për raportin e VNM-së nuk mund të jetë më i shkurtër se tridhjetë (30) ditë. Të gjitha debatet publike duhet të mbahen në institucione publike komuna ku zbatohet projekti. Ligji po ashtu përcakton se debati publik mbahet në formë fizike dhe virtuale,¹⁴ duke u dhënë mundësi kështu të gjitha palëve të interesuara të marrin pjesë, pavarësisht mundësisë për të qenë fizikisht në debat publik.

¹³ Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. I qasshëm në Gazetën Zyrtare: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68708> (qasur me 04.12.2023)

¹⁴ Po aty, neni 16(8)

Sipas nenit 17, paragrafi 1 të ligjit, Komisioni i VNM-së në afat prej njëzet (20) ditësh nga dita e mbajtjes së debatit publik, është i detyruar që të shqyrtojë vërejtjet dhe mendimet e dala nga debati publik, si dhe përgjigjet e dhëna nga hartuesi.

Për fund, neni 25 i ligjit përcakton se mbikëqyrjen inspektive për zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore që derivojnë nga ky ligj e kryejnë **inspektorët për mbrojtjen e mjedisit** në bazë të ligjit përkatës me të cilin rregullohet veprimtaria e inspektoratit për mbrojtjen e mjedisit dhe ligjin përkatës për inspektimet.

Në përgjithësi, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis nuk trajton detajisht qështjen e qëndrueshmërisë mjedisore nga perspektiva e aftësisë së kufizuar dhe të drejtave të fëmijëve. Ajo çfarë ofrohet si mundësi nga ky ligj është përfshirja në diskutime publike dhe dërgimi i komenteve lidhur me VMN për projekte të caktuara, e cila është mundësi për organizatat e shoqërisë civile por edhe komunitetin në përgjithësi, për të ngritur shqetësime potenciale lidhur me projekte të caktuara të cilat potencialisht mund të kenë ndikim negativ në mirëqenie apo shëndet.

3.4. Obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në raport me legjislacionin dhe politikën mjedisore

- **Obligimet që derivojnë nga Marrëveshja për Stabilizim-Asociim** - Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim me Bashkimin Evropian dhe ligji për ratifikimin e kësaj marrëveshje është aprovuar në Kuvend në nëntor të vitit 2015. Nenet 115 dhe 116 të MSA obligojnë Kosovën për: *“bashkëpunimin në fushën e mjedisit me detyrën shumë të rëndësishme të ndalimit të degradimit të mëtejshëm mjedisor dhe fillimin e përmirësimit të gjendjes mjedisore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë”*.

Përmes MSA-së, Republika e Kosovës është obliguar poashtu në bashkëpunim me qëllim të fuqizimit të strukturave dhe procedurave administrative, për të siguruar planifikimin strategjik të çështjeve mjedisore dhe koordinimit midis aktorëve relevantë dhe do të përqendrohet në përafrimin gradual të legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së. Bashkëpunimi mundet gjithashtu të përqendrohet në zhvillim të strategjive nga Kosova, për të zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme ndotjen e ajrit dhe e ujit në nivel lokal, rajonal dhe ndërkufitar, për të krijuar një kornizë për prodhim dhe konsum të energjisë efikase, të pastër, të qëndrueshme dhe të rinovueshme, dhe për të realizuar vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe vlerësimin strategjik mjedisor.

Përmes MSA-së, Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian do të bashkëpunojnë me qëllim që të ndihmojë Kosovën të zhvilloj politikën e saj klimatike dhe të i përfshijë shqetësimet klimatike në energji, transport, industri, bujqësi, arsim dhe në politikat tjera përkatëse.

- **Raporti i BE-së për Republikën e Kosovës** – Për çdo vit, Bashkimi Evropian, konkretisht Komisioni Evropian, lanson raportin vjetor për Republikën e Kosovës, e cila paraqet progresin e realizuar dhe ngeçjet në pothuajse të gjitha fushat dhe sektorët, duke përfshirë edhe mjedisin.

Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023¹⁵, Kosova ka bërë shumë pak sa i përket përbueshjes së objektivave që dalin nga MSA dhe Agjenda e Gjelbër. Konstatimet kryesore të Raportit për Kosovën të KE për vitin 2023 në fushën e mjedisit janë:

- Kosova është në një fazë të hershme në fushat që kanë të bëjnë me Agjendën e Gjelbër;
- Duhet të rritet angazhimi politik dhe kapacitetet administrative për të trajtuar degradimin e mjedisit dhe ndryshimet klimatike;
- Ndotja e ajrit vazhdon të jetë një kërcënim i madh për shëndetin;
- Paqëndrueshmëria e sistemit dhe mungesa e praktikave të duhura të menaxhimit të mbetjeve janë shqetësime;
- Nevoja urgjente për sisteme monitorimi dhe zona të zgjeruara të mbrojtjes së ujit;
- Nuk ka përparim të rëndësishëm në fushën e mbrojtjes së mjedisit; strategjitë për zhvillimin e mjedisit dhe planet e veprimit të biodiversitetit kanë nevojë për zbatim të plotë;
- Nuk ka përparim domethënës në vlerësimin e nevojave për rrezikun e fatkeqësive dhe zbatimin e strategjisë së ndryshimeve klimatike.

Rekomandimet konkrete që dalin nga Raporti për Kosovën në fushën e mjedisit janë:

- Zbatimi me efikasitet dhe në kohë të Strategjisë së Energjisë;
- Përmirësimet e menaxhimit të mbetjeve, duke rritur mbulimin e grumbullimit, riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve, zbatimi i masave të ekonomisë qarkore;
- Veprimi për ndryshimet klimatike, përmes zbatimit të Strategjisë dhe planit të veprimit për ndryshimet klimatike, përgatitja e një udhërrëfyese për përafrimin me Agjendën e Gjelbër, miratimi i Planit kombëtar për energji dhe klimë, finalizimi i strategjisë afatgjatë të dekarbonizimit;
- Rritja e kapaciteteve administrative dhe teknike;
- Zbatimi i masave për të reduktuar ndotjen e ajrit dhe respektimi i tavaneve të emetimeve;
- Zbatimi i masave efektive për mbrojtjen e parqeve kombëtare dhe specieve të rrezikuara;
- Forcimi i kapaciteteve për të zbatuar legjislacionin mbi emetimet industriale dhe për të reduktuar mbetjet e rrezikshme.

Po ashtu, më 10 nëntor 2020 në Samitin e BE për Ballkanin Perëndimor liderët evropian aprovuan **Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor**¹⁶, e cila parasheh hamronizimin e

¹⁵ European Commission: Kosovo Report 2023. I qasshëm në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2023_en (qasur me 05.12.2024)

¹⁶ RCC: Deklarata për Agjendën e Gjelbër në Ballkanin Perëndimor. E qasshme në: <https://www.rcc.int/docs/546/sofia-declaration-on-the-green-agenda-for-the-western-balkan> (qasur me 05.12.2023)

politikave dhe legjislacionit të vendeve të Ballkanit Perëndimor me vendet e Bashkimit Evropian.

- **Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm** - Edhe pse nuk është nënshkruese e Agjendës 2030 dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së për shkak të statusit të saj si jo-anëtare, Republika e Kosovës mori vendimin t'i bashkohet përpjekjeve globale për të përqafuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe OZhQ-të (SDG-të.) Zbatimi i Agjendës 2030 dhe OZHQ-ve në Kosovë, i cili ka qenë vullnetar në këtë kontekst, sigurohet përmes miratimit nga Kuvendi i Kosovës në janar 2018¹⁷ të një rezolute parlamentare që miraton OZhQ-të, të mbështetur fuqishëm nga Ekipi i Kombeve të Bashkuara për Kosovën. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm janë një thirrje globale për veprim për t'i dhënë fund varfërisë, për të mbrojtur mjedisin dhe klimën e tokës dhe për të siguruar që njerëzit kudo që janë të mund të gëzojnë paqe dhe prosperitet.

Objektivat e OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDGs) janë në thelb të secilit prej tyre strategjinë mjedisore, sociale dhe të qeverisjes të biznesit, dhe potencojnë nevojën që personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje të barabartë në:

- Arsim cilësor (*Objektiva 4*)
- Punë të denjë dhe rritje ekonomike (*Objektiva 8*)
- Reduktim të pabarazive (*Objektiva 10*)
- Qytete dhe komunitete të qëndrueshme (*Objektiva 11*)
- Partneritetet globale për zhvillim të qëndrueshëm (*Objektiva 17*)

Në anën tjetër, pothuajse të gjitha objektivat për zhvillim të qëndrueshëm në qendër të tyre kanë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve. Siç raportohet nga UNICEF¹⁸, secila nga objektivat ka ndërlidhje direkte me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, e cila është e aplikueshme edhe në Republikën e Kosovës. Rrjedhimisht, të gjitha obligimet që dalin nga këto objektiva, Republika e Kosovës është zotuar se do t'i implementojë.

4. Përfundim dhe Rekomandime

Legjislacioni mjedisor në fuqi, që merr parasysh edhe perspektivën e aftësisë së kufizuar dhe të drejtat e fëmijëve, paraqet bazë për zhvillim të kampanjave të ndryshme avokuese që ndërlidhen me çështjen në fjalë. Siç është elaboruar në detaje në sesionet paraprake, legjislacioni mjedisor

¹⁷ Faqja zyrtare e Kuvendit të Kosovës, e qasshme në: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/zhvillimi-i-qendrueshem/progresi-i-kosoves-per-ozhq-te-ne-vitin-2018> (qasur me 05.12.2023)

¹⁸ UNICEF: Hartëzimi i Objektivave Botërore për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Konventës për të Drejtat e Fëmijës. E qasshme në: <https://www.unicef.org/albania/media/751/file/Hart%C3%ABzimi%20i%20Objektivave%20Bot%C3%ABrore%20p%C3%ABrZhvillimin%20e%20Q%C3%ABndruesh%C3%ABm%20dhe%20Konvent%C3%ABs%20p%C3%ABr%20t%C3%AB%20Drejtat%20e%20F%C3%ABmij%C3%ABs.pdf> (qasur me 05.12.2023)

duhet të marrë parasysh një sërë indikatorësh në mënyrë që të sigurojë përfshirjen e perspektivës së aftësisë së kufizuar dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Republika e Kosovës qëndron relativisht mirë në harmonizimin e legjislacionit me BE-në sa i përket aspektit të mjedisit. Megjithatë, ligjet e analizuar më lartë, sidomos ai për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, nuk përmbanë shumë dispozita, siç është elaboruar detajisht në *kapitullin 3.3* të kësaj analize, të cilat do të trajtonin perspektivën e aftësisë së kufizuar apo mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Lidhur me ligjet e lartpërmendura, mund të identifikohen disa fusha/çështje për të cilat organizatat e shoqërisë civile, palët e interesit apo thjeshtë qytetarët individualisht mund të angazhohen dhe të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme, me qëllime të informimit dhe të avokimit. Angazhimi në aktivitete të tilla përfshinë:

- Pjesëmarrje në vendimmarrje – Kjo e drejtë është e garantuar me Kushtetutë dhe e rregulluar më tej me legjislacionin në fuqi. Qytetarët dhe organizatat e ndryshme gëzojnë të drejtën e plotë për t'u angazhuar në hartim të legjislacionit dhe politikave publike, paraqitje të pikëpamjeve me shkrim dhe me gojë në dokumente e legjislacion që është duke u hartuar, të marrin pjesë në diskutime publike dhe të paraqesin pikëpamjet e tyre për çështje të caktuara;
- Qasja në informata – E drejta e informimit është e drejtë fundamentale, e garantuar jo vetëm me legjislacionin e Republikës së Kosovës por edhe me konventa ndërkombëtare. Qytetarët dhe OJQ-të kanë mundësi të ndryshme (të sqaruara në këtë punim) për t'u informuar lidhur me politikat dhe çështjet mjedisore. Këtë të drejtë për qasje në informata qytetarët e gëzojnë edhe për nivelin qëndror edhe për atë lokal;
- Përfshirja në rishikimin e Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit – Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit ka paraparë mundësinë që Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit të rishikohet çdo dy vjet, duke mundësuar po ashtu edhe dhënien e inputeve nga qytetarët dhe shoqëria civile. Ky është një ndër dokumentet kryesore të kësaj natyre, dhe pjesëmarrja në hartimin e saj do të përbente një hap të rëndësishëm drejt avokimit për çështje të caktuara, sidomos atyre që ndërlidhen me perspektivën e aftësisë së kufizuar dhe të drejtat e fëmijëve;
- Ndërveprimi me komisionin parlamentar për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim – Komisioni parlamentar për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim është komision funksional i Kuvendit të Kosovës, i mandatuar për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve nga fushëveprimtaria e tij, dhe njëkohësisht mbikëqyrjen e punës së ministrive që bien në fushëveprimtari të këtij komisioni. Ky komision parlamentar është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të të gjitha ligjeve të lartpërmendura, dhe një qasje proaktive e anëtarëve të këtij komisioni do të siguronte zbatim të duhur të ligjeve që ndërlidhen me mjedisin. Për më tepër, me hyrjen në fuqi të Rregullores së re të punës së Kuvendit, dy e më shumë komisione mund të bashkërendojnë aktivitetet e tyre në aktivitete mbikëqyrëse. Si rrjedhojë, është e domosdoshmë që të bashkëpunohet edhe me komisionin parlamentar për të drejtat e njeriut, dhe përmes të dy këtyre komisioneve të kërkohet zbatimi i ligjeve

për mjedisin, njëkohësisht duke garantuar perspektivën e aftësisë së kufizuar dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Për më tepër, rekomandime konkrete për institucionet qendrore dhe lokale, lidhur me integrimin e perspektivës së aftësisë së kufizuar dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe garantimin e qëndrueshmërisë mjedisore të legjislacionit përfshijë:

- **Për MMPHI:** Të integrohen parimet e dizajnit universal në strategjitë e përshtatjes klimatike për të siguruar që ndryshimet e infrastrukturës marrin parasysh nevojat e individëve me aftësi të kufizuara. Kjo përfshin strehimore të qasshme, planet e evakuimit dhe sistemet e komunikimit.
- **Për Ministrinë e Arsimit dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit:** Zhvillimi dhe zbatimi i programeve arsimore mbi ndryshimet klimatike që janë të arritshme dhe gjithëpërfshirëse, duke marrë parasysh stile të ndryshme të të mësuarit dhe nevojat e komunikimit.
- **Për Komunitat:** Jepni përparësi opsioneve të transportit publik të qasshme dhe gjithëpërfshirës si pjesë e planifikimit të qëndrueshmërisë klimatike për të siguruar që individët me aftësi të kufizuara mund të evakohen në mënyrë të sigurt gjatë ngjarjeve ekstreme të motit.
- **Për MMPHI dhe Komunitat:** Projektimi i hapësirave të gjelbra dhe projekteve të planifikimit urban duke pasur parasysh qasjen, duke ofruar veçori të tilla si shtigje të qasshme, pritore si dhe sinjalistikë adekuate për personat me aftësi të kufizuara.
- **Për Ministrinë e Arsimit dhe Komunitat:** Investimi dhe përkrahja e programeve në zhvillimin dhe promovimin e teknologjive ndihmëse që ndihmojnë individët me aftësi të kufizuara të përshtaten në ndryshimin e kushteve klimatike.
- **Për Qeverinë e Kosovës:** Promovimi i "punëve të gjelbërta", përmes lehtësimit të qasjes në trajnime dhe mundësi punësimi në sektore të ndryshme që ndërlidhen me ambientin dhe klimën, për individët me aftësi të kufizuara, duke siguruar që fuqia punëtore të jetë e larmishme dhe gjithëpërfshirëse.
- **Për Kuvendin, Qeverinë dhe OJQ-të:** Të avokohet dhe të sigurohet pjesëmarrja në zhvillimin e politikave klimatike që marrin parasysh në mënyrë eksplicite nevojat dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe të drejtat e fëmijëve, duke siguruar përfshirjen e tyre aktive në proceset vendimmarrëse.
- **Për Qeverinë dhe Komunitat:** Të dizajnohet dhe planifikohet organizimi i trajnimeve gjithëpërfshirëse për gatishmërinë dhe reagimin ndaj fatkeqësive për shërbimet e urgjencës, reaguesit e parë dhe publikun e gjerë për të siguruar që individët me aftësi të kufizuara të merren parasysh në situata krize.
- **Për mediet dhe institucionet publike:** Sigurohuni që informacioni, paralajmërimet dhe materialet e komunikimit të lidhura me klimën të jenë të qasshme për individët me aftësi

të kufizuara. Kjo përfshin ofrimin e informacionit në formate të ndryshme, të tilla si braille, printim të madh dhe përdorimi i gjuhës së shenjave.

- **Për OJQ:** Bashkëpunoni me organizatat dhe individët që mbrojnë aftësinë e kufizuar për të siguruar që iniciativat dhe politikat mjedisore të jenë gjithëpërfshirëse dhe të kenë parasysh nevojat e ndryshme.
- **Për institucionet publike dhe OJQ-të:** Organizoni ngjarje të veprimit për klimën, konferenca dhe aktivitete të angazhimit të komunitetit që janë të qasshme për të gjithë, duke siguruar që individët me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë plotësisht.
- **Për MMPHI:** Zbatimi i praktikave të qëndrueshme të ndërtimit në ndërtesa, të cilat gjithashtu kanë prioritet aksesueshmërinë, duke krijuar shtëpi që janë efektive në energji dhe të dizajnuara në mënyrë universale.

Rekomandime specifike për OJQ-të, të cilat mund të ndihmojnë në dizajnimin dhe implementimin e programeve specifike:

- Hartoni dhe ofroni trajnime edukative që janë të përshtatura për nevojat dhe interesat specifike të personave me aftësi të kufizuara
- Përdorni metoda dhe mjete të ndryshme për të komunikuar informacionin e ndryshimeve klimatike në një mënyrë tërheqëse dhe efektive, të tilla si lojëra ndërvepruese, tregime, art, muzikë dhe gjuhën e shenjave;
- Promovimi i teknologjive ndihmëse që janë të përshtatshme për kushte dhe rreziqe të ndryshme mjedisore;
- Bashkëpunimi me organizatat dhe komunitetet lokale për të rritur ndërgjegjësimin dhe avokimin për të drejtat dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara në kontekstin e ndryshimeve klimatike;
- Ofrimi i trajnimeve dhe udhëzimeve se si të përdorim teknologjitë tona ndihmëse në mënyrë efektive dhe të sigurt;
- Lidhja e individëve me aftësi të kufizuara me mundësitë përkatëse të trajnimit dhe edukimit, të tilla si kurse, seminare, praktika etj;
- Ofrimi i mentorimit dhe trajnimit të vazhdueshëm për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara të kenë sukses dhe të rriten në karrierën e tyre të gjelbër.

Në mënyrë që kampanjat avokuese të jenë të suksesshme, është e nevojshme që të njihen institucionet përgjegjëse për zhvillimin dhe implementimin e legjislacionit dhe politikave, në nivelin qëndror dhe lokal. Disa nga institucionet kryesore me të cilat rekomandohet të ketë ndërveprim të vazhdueshëm janë:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës;
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, përkatësisht Komisioni Parlamentar për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

- Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Inspektorati Mjedisor i Ministrisë;
- Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Komunitet e Republikës së Kosovës. Gjegjësisht Inspektorati Komunal i Mjedisit.